



KOMUNA E KLINËS
KUVENDI I KOMUNËS

01. Nr. 060-2058/18
KLINË, 28.2.2018

PROCESVERBALI

I SEANCËS SË DYTË TË KK, MBAJTUR, MË 28.2.2018, NË ORËN 10.00, NË SALLËN E KK

Në seancë prezantuan: Kryetari i Komunës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, nënkryetari i Komunës, Besim Hoti, anëtarët e KK (27), drejtorë të drejtorive, Zyra ligjore, Policia e Kosovës, komandanti Rexhë Berisha, KFOR-i, OSBE, Zyra për Barazi Gjinore, OJQ-të, mediet etj.

Seancën e udhëhoqi kryesuesi i KK, Fadil Gashi, i cili fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe ju dëshiroi mirëseardhje në këtë seancë të KK-së.

“Kujtoj se bashkë me materialin dhe ftesën para vetes veç keni gjetur edhe disa materiale të tjera. Ne veç kemi premtuar për këtë seancë të keni edhe LVL edhe Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe Komiteteve. Ne i kemi punuar ato, i keni para vetes. E keni një formular , megjithëse është përcjellë edhe përmes postës elektronike për plotësimin e pesë zotimeve që ju duhet t'i plotësoni vetë për mjediset e juaja secili anëtar dhe, ju kisha lutur plotësoni ata formularë dhe t'i dorëzoni pastaj në shërbim të kuvendit. Po ashtu, është formulari për deklarimin e pasurisë, që po ju shpërndanë asistentja, që duhet të plotësohen. Ju e dini që në raportimet e rregullta që bëhen, fillon prej 1 marsit deri më 31 mars 2018, duhet të plotësohen pra formularët për deklarimin e pasurisë. Ju kisha lutur të mos kalojë kjo datë, sepse pastaj për 3-4 vjet po i merr gjykata për këtë gjë. Ju konfirmoj se prezent jemi 27 anëtarë të Kuvendit dhe nuk kemi asnjë mungesë nga ana e anëtarëve. Pos rendit të ditës, nëse më lejoni, unë ju kisha njoftuar që kam për obligim për ta propozuar një ndryshim të rendit të ditës, sepse ne veç kemi marrë të premtën e kaluar konfirmimin të joligjshmërisë të një vendimi që kemi nxjerrë në seancën e kaluar. Ne jemi të obliguar sipas kërkesës së ministrisë për ta shqyrtuar vendimin tonë, formimin e KPF-së, na e kanë anuluar, ne duhet për të proceduar dhe plotësuar sipas kërkesës 50 me 50 të gjinisë. Unë për hir të korrektësisë kam biseduar me shefat e grupeve kuvendare, ne kemi mbajtur një takim dhe kemi bërë përpjekje të dakordohemi për aq sa kemi mbërri. Por, fillimisht, më duhet përkrahja juaj për ta futur në rend të ditës. Ju e dini se afati i rishqyrtimit të këtij vendimi është 30 ditë. Nëse nuk e procedojmë në këtë seancë neve na duhet për ta mbajtur një seancë tjetër të jashtëzakonshme, por pasi që kemi mundësi sot nuk e shoh të arsyeshme për ndonjë seancë të jashtëzakonshme, kur kemi mundësi që me këtë çështje të procedojmë sot”, ka sqaruar kryesuesi Gashi, i cili në vijim vuri në miratim pikën shtesë të rendit të ditës: Rishqyrtimi i Vendimit për themelimin e KPF-së, sipas kërkesës së MPL.

Me vota unanime (27) u miratua propozimi për futjen në rend të ditës, në pikën 7, Rishqyrtimi i vendimit për themelimin e KPF-së, sipas kërkesës së MPL.

RENDI I DITËS

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,

3. Pyetje dhe përgjigje,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-planit të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve për vitin 2018,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-planit të Veprimit për Transparencë në Komunë për vitin 2018,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Prokurimit për vitin 2018,
7. Rishqyrtimi i Vendimit për themelimin e KPF-së, sipas kërkesës së MPL,
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Financiar të Komunës për vitin 2017,
9. Shqyrtimi dhe miratimi i themelimit të pesë komiteteve tjera të Kuvendit.

Pika e Parë: Arsyetimi i mungesave.

Kryesuesi sqaroi se nuk ka mungesa nga ana e anëtarëve të Kuvendit, të gjithë janë prezent.

Pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.

Kryesuesi hapi debatin rreth procesverbalit të seancës së kaluar të KK.

Valmir Bacaj, tha se unë kam një vërejtje të vogël rreth procesverbalit të seancës së kaluar, përkatësisht tek fjalimi im. “Në procesverbal shkruan se përbërja e Komitetit reflekton përfaqësimin e entiteteve dhe kërkohet me përqindje. Në fakt unë kam thënë se përbërja e komiteteve reflekton përfaqësimin e entiteteve dhe nuk kërkohet përqindja, sepse kështu e përcakton Ligji për Vetëqeverisjen Lokale. Kështu që, domethënë, ky gabim e ndryshon komplet kuptimin e fjalisë”, ka shtuar anëtari Bacaj.

Enver Gashi, tha po ashtu edhe ne kemi një vërejtje, nr. 11, ku bëhen propozimet për anëtarë të Komisionit intervistues, në procesverbal është shkruar gabim: “Enver Berisha propozoi Saranda Zeqën (LDK), duhet të jetë Enver Gashi propozoi Saranda Zeqën, pra më është ndryshuar mbiemri”, tha anëtari Gashi.

Vuri në miratim procesverbalin me vërejtjet e bëra.

Me 27 vota pro u miratua procesverbali i seancës së kaluar me vërejtjet e bëra.

Pika e tretë: Pyetje dhe përgjigje.

Fadil Gashi, tha se edhe kjo është risi që e kemi filluar kështu, pyetje-përgjigje, për anëtarë të Kuvendit, që kanë diçka. “Kohëzgjatja maksimale është 10 minuta. Nuk do të thotë që ne gjithqysh për t’i shfrytëzuar, por nëse shkohet deri në 10 minuta, do të thotë ka hapësirë për pyetje dhe përgjigje për çështje të caktuara që anëtarët e Kuvendit mund t’i kenin nëse kanë dëshirë për t’i bërë karshi ekzekutivit ose të cilësdo çështje tjetër. Është e lirë, është e hapët, është e pakufizuar, në kuptimin e temave, por në kuptimin e kohës është 10 minuta, nëse ka dikush urdhëroni”, sqaroi Kryesuesi, i cili në vijim fjalën iu dha anëtarëve të Kuvendit.

Enver Berisha, tha se duke e pasur parasysh kohën në të cilën jemi dhe rrethanat klimatike që i kemi, unë kisha kërkuar nga drejtori i Shërbimeve Publike të na jep një informacion mbi gjendjen si e kemi në terren të rrugëve dhe situatën në tërësi.

Zenun Elezaj (Kryetar i Komunës), sqaroi pyetjen e anëtarit Berisha: “Drejtori i Shërbimeve Publike është në terren dhe, në aspektin e shpjegimit të situatës së rrugëve vërtet ndoshta jemi të pakënaqur,

edhe unë personalisht. Jemi takuar, kemi thirrur kompaninë dhe kemi kërkuar vazhdimisht, edhe unë personalisht kam dalë disa herë në terren. Kështu që, me gjasë kompania ka pak probleme edhe me mekanizëm, gjendja mekanike nuk është aq në gjendje të rregullt. Ju e dini se kemi trashëguar këtë kontratë dhe jemi munduar për të qenë të arsyeshëm. Edhe dje i kemi bërë vërejtje me shkrim për mosgatishmërinë e kompanisë, por ne nuk po ndalemi, po komunikojmë, po takohemi. Ata sa po munden po punojuni në terren, ndoshta pak edhe bora e bën të veten. Si ekzekutiv kemi marrë të gjitha masat që të jenë sa më në rregull rrugët. Ju thashë se edhe vetë nuk jam i kënaqur, mirëpo i kemi ndërmarrë masa të nevojshme, i kemi dhënë vërejtje kompanisë dhe do t'i shohim edhe penaltitetet tjera që mund t'i vëmë në terren. Ibri tash për tash është në terren me ta, sepse po duhet, edhe sepse i dhënë detyra për të shkuar, diku ku po e shohin se nuk është rregulluar rruga mirë. Ne jemi të pakënaqur dhe kemi bërë veprime të nevojshme të cilat na takojnë”, ka konstatuar kryetari Elezaj.

Gjokë Lleshaj, tha se po më bien për të bërë pyetje, përkatësisht shpjegim, që nuk është prezent, për drejtorin për Kulturë, Rini e Sport. “Ka tri ditë ose katër, që drejtoria, respektivisht punëtorët e DKRS-së nuk kanë rrymë edhe ata nuk janë në vendin e punës për arsye se temperaturat kanë qenë shumë të ulëta. Është lehtë të flitet, mirëpo bukur vështirë është të vepohet. Më vjen keq se nuk është këtu, sepse ai edhe për miza dhe mushkonja gjente “bishta” e fjalë. Ku është zotëri Skënder Merturi, që asnjë veprim nuk e ka ndërmarrë në këto 3-4 ditë. Kujt do për t'i dhënë llogari? Është e treta, e katërta ditë që nuk ka rrymë në Shtëpinë e Kulturës dhe nuk është bërë asnjë shqetësim, asnjë problem. Unë shpeshherë ndoshta nuk jam pajtuar ose nuk pajtohem me veprimet edhe tonat që i kemi pasur, por kemi bërë përpjekje së paku për të arsyetuar, ky së paku nuk e ka arsyetuar as vetveten as subjektin kurrë. Unë po kam shumë dyshime që mosprezenca e tij është me një qëllim të caktuar, sepse atë e pengonte..., e pengonte çdo gjë. Pasi nuk është këtu prezent kam dashur edhe një pyetje për t'ia bërë, mirëpo dua ta pres, sepse ai njihet këtu para nesh, edhe para jush, sepse ka qenë më i hareshmi në katër vitet e kaluara, por lehtë është për të folur, mirëpo kur të ulet në vendin e duhur atëherë i kupton gjerat. Një rrymë 4 ditë me munguar aty! Unë nuk dua ta luaj rolin e tij, sepse atë e pengonte edhe fotografia e... ku të di unë... Lehtë është për të folur, por pse ai se ka marrë një veprim. Nuk mund të arsyetoj katër ditë mos me pasur rrymë në objektin e Shtëpisë së Kulturës. Pastaj, edhe e gjënë arsyen të mos flas për disiplinë të punës ose korrektësisë brenda punës, këtë nuk dua ta lë, dua ta lë në një të ardhme që unë edhe sot kam fakte me fotografi dhe me xhirime që punëtorët nuk e respektojnë orarin e punës dhe vendin e punës. Këtë dua ta lë për më vonë qëllimisht, sepse asnjëherë nuk ka për ta luajtur lojën pikërisht të atij, por do të jem konstruktivë, do të flas gjithmonë me fakte, por jo me fjalë të rrugëve qysh është sjellë ai për katër vite”, ka theksuar anëtarë Lleshi.

Zenun Elezaj, tha se jo në kuptimin arsyetimit, por të njoftimit: “Skënderi është në një takim me organizatorët, organizohet një kros, më 3 mars prej Prekazit deri në Koshare. Faktikisht është i zënë edhe me atë organizim. Sa i përket, sigurisht se ti e ruan të drejtën për t'ia bërë edhe atij pyetjen drejtpërdrejt, por unë po flas në kuptim të shqetësimit tim. Jam në ngjarje për problemin e trafos, edhe në këtë kuptim jam i informuar. Jemi takuar dhe kemi kërkuar nga kompania, e cila ka bërë rregullimin, që të ndërmerr masa të nevojshme dhe realisht aty të drejtat tona i kemi shfrytëzuar maksimalisht. Kështu që, besoj që sot do të rregullohet kjo çështje, por gjithmonë pa dashur për të hyrë për të kaluarën, gjithmonë është një punë që është realizuar dhe është në garancion. Kompania që ka kryer punën e ka në garancion, po presim që për sot. Unë dje ju kam thënë për t'i ndërmarrë masat, ne i kemi pritur për sot, sepse ndoshta është e pamundur brenda dite, dhe po shpresojmë që sot ka për të pasur ndërhyrje, nëse jo unë do t'i ndërmarr të gjitha veprimet e lejuara që na lejohen si ekzekutiv”, ka pohuar kryetari Elezaj.

Avni Gashi, tha se unë sot këtu do të dalë për ta falënderuar një organizatë të Klinës, është fjala për zjarrfikësit, të cilët me veprimin e djeshëm ka rastisur për të qëlluar në shtëpinë e vëllait, për 16 minuta më shpejtësi që kanë ardhur, kanë arritur për ta shpëtuar djegien e shtëpisë komplet. “Ajo çka po dua të them që tha kryetari, problemet që ka me kompani, ndërsa unë këtu përpos për të falënderuar, është mirë për t’i potencuar ato asete që ka Komuna e Klinës dhe ata për t; i përkrahur dhe për t’iu shkuar, jo vetëm kur të na ndodhë në këtë rast sikur mua, por të shkohet dhe të shihen hallet e tyre, se më të vërtetë profesionalizmi brirë nuk ka, kur arrijnë për ta bërë atë intervenim, të mbërrin prej Kline për 16 minutë, unë nuk di as qysh kanë ngasur as atij kamioni. Ka qenë një intervenim i mrekullueshëm, që kanë bërë një mrekulli. Kur i kemi këto asete në Komunën tonë duhet për t’i vlerësuar, jo vetëm kur të na ndodh problemi. Këtu nuk po dua t’i jap vlerësimet as drejtorit të tanishëm, as drejtorit të kaluar, por thjeshtë zjarrfikësit e Klinës vërtetë janë të mrekullueshëm”, ka shtuar anëtari Gashi.

Besart Hoti, tha se nëse më lejohet desha të prezantohem me dy pyetje: “E para është lidhur me një konkurs të hapur në shkollën fillore “Ali Krasniqi” në Ujmir, për sekretar shkolle, por kualifikimi adekuat cekët ekonomik ose menaxher , përkatësisht menaxhment. Ne e dimë që menaxheri i shkollë është drejtori, për mirëmbajtjen e administratës kualifikimi, edhe në konkurs të mëhershëm ka qenë juridik ose administrim publik, kjo është zoti drejtor. Edhe pyetja e dytë, jam mësimdhënës i shkollës fillore në Jashanicë, janë dhjetë klasë, në lëndën e gjuhë angleze fondi i orëve të humbura është afër njëqind, a do të zëvendësohen këto orë apo qysh do t’ia bëjmë?”, pyeti anëtari Hoti.

Arben Limani, iu përgjigj pyetjeve të anëtarit Hoti. “ Konkursi për sekretar në shkollën në Ujmir me plotësim në Çabiq ka dalë këtu ditëve të fundit, edhe sekretar hyn të pjesa e shërbyesve civilë. DKA e bën kërkesën te Zyra e personalit për shpallje të konkursit për nevojën që kemi, në këtë rast për sekretar shkolle, ndërsa procedurat e konkursit i shpallë Zyra e personelit, me kriteret, me të gjitha ato që hynë në kuadër të kompetencave që i ka një sekretar shkolle, merret Zyra e personelit. A më kriteret me kërkesë nuk shkojnë nga ne. Ndërsa, te orët e humbura të gjuhës angleze, ne e dimë që procedurat e konkursit tash na u kanë komplikuar pak që neve nuk na konvenojnë si Drejtori e Arsimit. Ata që punojnë në arsim, e dinë, e njohin këtë fakt, me një UA të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale 7/2017, i cili e qartëson çështjen e procedurave të pranimit të kuadrit arsimor. Edhe e dimë që procedura e konkurrimit për 17 ditë, pastaj vazhdohet, pritet procesi i ankesave të ndryshme nga kandidatë të mundshëm edhe deri te shpallja e atij kandidati që ka marrë të drejtën ose e ka fituar të drejtën për të qenë në atë vend pune. Orët e humbura sigurisht që do të zëvendësohen, në konsultim bashkë edhe me drejtorin e shkollës, përkatësisht përgjegjësinë, do të mundohemi për t’i kompensuar. Një ankesë të tillë e kemi pasur edhe për një mësues klase në Ujmir, mirëpo nuk mund të dalim jashtë procedurave të cilat na i ngarkon ligji ose UA”, ka shtuar drejtori Limani.

Fadil Gashi, tha se për të ardhmen kisha pasur dëshirë pyetjet që, në jemi njerëz, se di çka keni për të pyetur këtu, për atë është kjo hapësirë, një pyetje mund të merr përgjigjen për seancën e radhës, se nuk lëndon asgjë, përgatitet edhe drejtori, edhe cilido qoftë prej ekzekutivit, për disa pyetje përgjigje mund të jepet në seancën e radhës që vjen. Po konsideroj se e kemi mbyllur këtë pikë”, tha Kryesuesi.

Pika e katërt: Plani i Punës së Kuvendit dhe Komiteteve për vitin 2018.

Fadil Gashi, e keni përpara Planin e punës, edhe kalendarin bashkë me të, nëse ka ndokush urdhëroni! “Nuk i kemi komitetet tjera, madje nuk i kemi as ato obligative. Ne kemi qenë të kushtëzuar për të pritur kushtëzimin e ligjshmërisë. Duke shpresuar se na përgatisin edhe kalendarin e komiteteve dhe e bëjmë

një të përgjithshëm dhe më në fund ne e formuam këtë dhe tash mund t'i bashkohen komitetet pa përjashtim sa janë 9, pritet për t'u themeluar edhe 5 sot, edhe i bashkohen kalendarit të përgjithshëm. Unë kisha propozuar se atje nuk e keni në material, por kisha propozuar që në fund të jetë një pasus” Për çdo situatë tjetër, që ka nevojë për t'u thirrur Kuvendi, ne i dimë seancat e jashtëzakonshme, por edhe me lëvizur data e rregullt qysh e keni atje, ta lëmë si pasus: “I referohemi nenit 43 të LVL se si thirren seancat e Kuvendit”. Pse po e them këtë: Nëse eventualisht ka ndonjë nevojë për ta ndryshuar datën, për ta mos e mbajtur të premtën e fundit qysh ne e kemi bërë një propozim atje, por që po duam ta mbajmë të enjten apo një ditë tjetër të javës. Neve na nevojitet për të marrë vendim, pastaj seanca për ta anuluar atë vendimin që kemi marrë. Pra, veç për t'i ikur kësaj procedure, sepse nuk bëjmë prapë pa koordinim asgjë. Pra, të jetë si plotësim, si pasus”, konstatoi kryesuesi Gashi, i cili në vijim hapi debatin rreth Planit të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve për vitin 2018”, ka theksuar kryesuesi Gashi.

Enver Berisha, tha se në emër të Grupit Kuvendar të PDK-së, ne e kemi analizuar, e pamë orarin e takimeve dhe i dakordua që kjo për momentin të mbetet në këtë formë. “Unë kisha kërkuar që edhe grupet tjera kuvendare të pajtohen me këtë plan dhe kalendar të Kuvendit dhe komiteteve dhe të mos na merr shumë kohë në Kuvend”, tha anëtari Berisha.

Petrit Palushi, tha se edhe unë deklarohej se jam pro këtij vendimi dhe kërkoj që të procedojmë më tutje.

Violeta Zefi, tha se edhe ne si Grup Parlamentar i LDK-së e mbështesim këtë vendim dhe jemi në dakord të procedohet.

Kryesuesi vuri në miratim Planin e Punës së Kuvendit dhe Komiteteve për vitin 2018.

Me 20 vota u miratua Plani i Punës dhe Kalendarit për Kuvendin dhe Komitetet për vitin 2018.

Pika e pestë: Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-planit të Veprimit për Transparencë në Komunë për vitin 2018.

Fadil Gashi, tha se edhe këtë material ju e keni para, unë ju përkujtoj sipas infrastrukturës ligjore jemi të obliguar për çdo vit për të hartuar dhe miratuar Planin e veprimit për transparencë. “Këtu përfshihen të gjitha organet e komunës Kuvendi, drejtoritë. Është një plan që për çdo vit përsëritet. Ju e keni kështu qysh e keni para jush. Ne kemi i planifikuar për vitin 2018 kështu për të qenë. Ne shohim deri në fund të vitit kah ka ngecje më shumë, edhe për vitin tjetër mund ta sanojmë atë, mund ta plotësojmë, por kemi për çdo vit Planin e Veprimit për Transparencë për ta miratuar në Kuvend”, konstatoi Kryesuesi i cili në vijim hapi diskutimin rreth draft-planit”, shtoi Kryesuesi.

Enver Berisha, tha se unë realisht e përshëndes këtë iniciativë për hartimin e këtij Plani të veprimit. “Realisht, kjo buron edhe nga ligji, edhe nga rregullorja që ne kemi aprovuar vitin e kaluar për transparencë dhe besoj që sado që stafi për 18 vite rresht është aftësuar, është profesionalizuar, ka kryer trajnime të ndryshme dhe kjo mund t'i lihet hapësirë edhe të mëtutjeshme zyrtarë të caktuar të pranohen, të aftësohen, për implementimin e këtij Plani të Veprimit për Transparencës. Mirëpo, nuk i di dy gjera: mendoj që ndoshta është dashur të planifikohen, këtu nuk shihet edhe kostoja buxhetore, nuk është planifikuar. Prandaj, sa do të jetë ajo kosto për implementimin e këtij plani të veprimit dhe, a parashihet afat kohor se deri kur do të jemi në kuadër të këtij plani, domethënë derisa të krijohet mundësia për ta

ndryshuar, gjegjësisht për ta plotësuar, dhe për të krijuar prapë elemente të reja në kuadër të këtij Plani të Transparencës. Domethënë, e para, kostoja buxhetore dhe plani dinamik i Planit të Veprimit”, ka konstatuar anëtari Berisha.

Fadil Gashi, tha se po me bie mua ta prezantoj këtë plan. “E para, te implikimet financiare tash drejtoria përkatëse me miratimin e këtij plani duhet për t’i ndërmarrë hapat konkretë. Po besoj që deri në qershor, për planifikime është fjala. Nuk i kemi ikur rregullores që ka miratuar Kuvendi, prandaj po them kjo është njëvjeçare. Edhe dinamika nëse thirrëmi në të është për këtë vit dhe gjithçka parashihet brenda këtij viti, është Plani i Veprimit për vitin 2018. Dhe çdo gjë që kalon pas vitit 2018 nuk është më brenda këtij plani ose ne nuk e kemi implementuar planin të cilin e miratojmë vetë. Kështu po e kuptoj dhe kështu duhet të kuptojnë të gjithë. Implikimet financiare duhet planifikuar me kohë, e kemi përpara qershorin, i kemi hapat e ndërtimit të kornizë buxhetore vjetore që fillojnë tash, pse jo për t’u përgatitur edhe për vitin 2019. Kjo është një fushë e ndjeshme, sidomos transparenca, llogaridhënia, vendimmarrja, ku gjithçka po lidhet edhe te kriteret tjera që po lidhen dhe po na kërkohet për t’i përmbushur dhe është mirë prej të gjitha tjerave që ne po mundohemi për të pasur si kriter edhe si plotësim. Prandaj, kështu është kjo, çfarë dëshironi të ndryshojmë, por t’i iket fort prej ligjit dhe prej rregullores që kemi miratuar nuk mundemi”, ka shtuar kryesuesi Gashi.

Enver Berisha, tha se unë po nisem prej përvojave që i kemi pasur në të kaluarën në të cilat ju personalisht disa herë i keni ngritur zërin. “Se, të aprovohet dokument nga AK që ka ndikime buxhetore, dhe, nëse nuk dihet kostoja buxhetore, përkatësisht nëse ai dokument nuk aprovohet përnjëherë edhe me koston buxhetore, pastaj po kemi telashe në ekzekutim të atij plani ose me cilindo segment që po vendoset”, ka pohuar anëtari Berisha.

Petrit Palushi, tha se mendoj që plani është në rregull dhe mbes me shpresë që të jetë në dinamikën e përcaktimit kohor. “Dhe, te kjo transparenca, që u tha edhe Enveri, që duhet të jetë e mbështetur në koston buxhetore. Ne duhet pritur kohën e rishikimit të buxhetit dhe ta mbështesim edhe këtë. Edhe në analizën që kemi bërë me grupin e asamblistëve të AAK-së pajtohemi që ky plan të vazhdojë kështu qysh është dhe të procedohet”, shtoi anëtari Palushi.

Kryesuesi vuri në miratim Draft-planin e Veprimit për Transparencë në Komunë për vitin 2018.

Me vota unanime (27) u miratua Plani i veprimit të Transparencës në Komunë për vitin 2018.

Pika e gjashtë: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së prokurimit

Rishqyrtimi dhe miratimi i Planit të Prokurimit për vitin 2018.

Avaz Foniqi, raportoi rreth Planit të prokurimit për vitin 2018. “Për sqarim, ky është planifikim i prokurimit, jo i punës së prokurimit, por planifikim i prokurimit për vitin 2018. Është i konceptuar në bazë të buxhetit të miratuar në këtë asamble dhe kërkesave të drejtorive përkatëse, të cilat do t’i iniciojnë planifikimet e tenderimit për vitin 2018. Në këtë plan ose planifikim ta quaj, ka edhe projekte që ndoshta nuk janë të mbuluara me buxhetin aktual, por është menduar në bazë të nevojave që drejtoritë përkatëse kanë planifikuar mund të fitohen grande ose donacione nga ndonjë ministria e linjave apo donacione tjera, participim me qytetarë. Do të thotë janë disa projekte edhe të dëshiruara, por me kushtin më të mirë që t’i kemi në planifikimin e prokurimit në mënyrë që të mos vonohemi në hapa, sepse nga Ligji i

prokurimit ato që nuk janë të planifikuara na marrin një kohë më të gjatë për t'u filluar ose për t'u implementuar në proceset e prokurimit. Për atë arsye edhe disa projekte janë të dëshiruara, por me dëshirën e madhe me planifikimin nga drejtoritë aktuale që janë konceptuar që mund të fitojnë grande nga ndonjë ministri ose nga ndonjë donacion tjetër”, ka sqaruar zyrtari Foniqi.

Esat Raci, kam dy pyetje: “Në nivelin lokal, sa i përket prokurimit, a ka gjasa që të jetë prokurimi elektronik në këtë vit, edhe nën dy: orientimisht, afatet kohore për ministrinë që dhënë projekte sa do të jenë? Në këtë rast përgatitet edhe një projekt nga Ministria e Zhvillimit Rajonal, mundësisht afatet kohore të na i tregoni”, pohoi anëtari Raci.

Abaz Foniqi, tha se këtë vit e kam më lehtë për të raportuar sepse ky buxhet është miratuar nga pozita e dikurshme e tani është në opozitë. “Por projektet të cilat janë të kërkuara për procedurë të prokurimit janë nga pozita e dikurshme që tash është në opozitë, do të thotë nuk shoh ndonjë fërkim që ky buxhet është i konceptuar. Prokurimi në Kosovë ka filluar. Çdo procedurë e prokurimit nga viti i kaluar duhet të iniciohet në platformën e prokurimit, asnjë letër, asnjë dokument nuk u jepet operatorëve ekonomikë sikurse i është dhënë deri me tani dosje të tenderit etj. Për çdo gjë në momentin e plasimit në platformën elektronike për një prezantues të prokurimit operatorët e interesuar atë dosje, atë dokument e shkarkojnë nga E-prokurimi. Mundësia edhe këtë vit është dhënë për t'i dorëzuar ofertat edhe me platformën e E-prokurimit, edhe në kopje fizike, por jo të dyja përnjëherë. Afatet janë të përcaktuara me ligj. Çdo procedurë e prokurimit në bazë të vlerës së madhësisë së kontratës dhe kodit funksional të atij projekti ka afatet e caktuara. Deri në 10 mijë euro afat është pesë ditore me e lënë të hapur atë procedurë, deri në vlerë deri 150 mijë euro për mallra dhe shërbime dhe 500 mijë euro për projekte kapitale, është minimumi 20 ditë e maksimumi qysh e potencova. Vlerat e mëdha kanë mbi 40 ditë, 100 mijë ose 500 mijë për projekte kapitale dhe mbi 150 mijë për mallra dhe shërbime. Do të thotë afatet e lejueshme janë këto: 5 ditë për vlerat e vogla, 20 ditë për vlerat e mesme dhe 40 ditë mbi vlerat e mëdha”, ka sqaruar zyrtari Foniqi.

Esat Raci, tha të na sqarohen procedurat: pak, shkurt dhe qartë.

Abaz Foniqi, tha se nëse Komuna e Klinës fiton një grand dhe shkruhet një marrëveshje, në momentin që shkruhet marrëveshja, nëse është i planifikuar ai projekt në planin tonë të prokurimit mund të fillojmë atë ditë që të vjen projekti, atë ditë që vjen zotimi, atë ditë që vjen marrëveshja, mund të fillohet dhe për 20 ditë kryhet. “Nëse nuk është në planin e prokurimit na mbesin 5 ditë për ta bërë kërkesën, për ta bërë planifikimin, për ta bërë zotimin edhe për ta dërguar në Autoritetin Qendror të Prokurimit për të hyrë në plan të të prokurimit për vitin 2018, nuk na pengon asgjë, edhe nëse nuk është këtu, një pesë ditë na i kërkon”, ka sqaruar zyrtari Foniqi.

Baki Gashi: Përshëndetje! “Planifikimi i prokurimit bëhet në bazë të miratimit të buxhetit dhe në bazë të planifikimit të drejtorive. Në materialin që kam unë në këtë plan kam vërejtur ndryshime, prandaj edhe kisha dëshiruar të me jepen sqarime. Kam vërejtur se asfaltimit të rrugëve në Volljak dhe Qupevë e Lartë i janë hequr 90.000,00 euro, pra janë të planifikuara vetëm 10.000,00 euro dhe te asfaltimi i rrugës në lagjen Dragaj, Klinafc, nuk është fare, si dhe mjetet e dedikuara për hartat zonale për këtë vit nuk janë të parapara”, ka theksuar anëtari Gashi.

Abaz Foniqi, sqaroi çështjen e ngrehur nga anëtari Gashi. “Më vjen keq që nuk qenkeni të informuar rreth dokumentit të dytë që ju ka ardhur. Në dokumentin e parë është bërë një lëshim teknik, Qupeva

është shkruar 10 mijë euro, duhet të jetë 100 mijë euro, në vend të 100 mijë është shkruar 10 mijë. Në adresë elektronike ju kemi dërguar sqarimin dhe tash ai projekt është 100 mijë euro. Rreth hartave zonale, e kam potencuar, ky është planifikim i prokurimit dhe nëse kemi një kontratë që procedurat e prokurimit janë kaluar, janë kryer vitin e kaluar sikurse është harta zonale, nuk kemi nevojë për ta përfshirë në planin e prokurimit këtë vit. Është i buxhetuar, kur të vjen momenti për të paguar paguhen për hartat zonale derisa plan i prokurimit nuk kemi nevojë më bërë procedurë të prokurimit për të. Edhe për rrugën Dragaj është, ndoshta ka ndonjë emër pak më ndryshe, por është diku, mund ta gjejmë, e korrigjojmë nëse nuk është. Derisa për projektet me donatorë janë të konceptuara me një buxhet që do të mbulojë mungesat e projekteve të kontraktuara dhe të atyre që kontraktohen që me participim me donatorë të ndryshëm dhe ajo vlerë nuk e ka një emërtim për të bërë procedurë të prokurimit”, ka sqaruar ndër të tjera zyrtari Foniqi.

Valmir Bacaj, një pyetje për menaxherin e Zyrës së prokurimit, planifikimi numër 4: pajisje të teknologjisë informative. “Për aq sa e vëreja unë ky tender është në fazën e tenderimit, domethënë është shpallur në prokurim, a bëhet fjalë për kontratë kornizë trevjeçare apo është njëvjeçare, sepse kishte mospërputhje në mes planifikimit dhe tenderit të shpallur në prokurim”, theksoi anëtari Bacaj.

Abaz Foniqi, tha se procedura e prokurimit për furnizim me pajisje të teknologjisë informative, është e konceptuar kontratë kornizë me një tender me shumë operatorë. Është, për herë të dytë që e bëjmë në Komunën e Klinës, është faza kualifikuese që do të kualifikohen sipas ligjit, 3 e më shumë operatorë, me kriteret të cilat janë të përcaktuara në dosjen e tenderit me ligjshmëri për një sasi të planifikuar dhe gjatë periudhës 36 mujore kur ne kemi nevojë për të blerë një sasi të pajisjeve, brenda kornizës, pas këtij specifikimi teknik u dërgohen të gjithë atyre operatorëve që janë kualifikuar, ata tashmë janë pjesë e marrëveshjes, i kanë plotësuar kriteret dhe u dërgohet oferta dhe pastaj vazhdohet sipas procedurave të parapara. Një marrëveshje shkruhet prej 3 deri 6 operatorë të kualifikuar. Sasia e planifikuar është indikative, gjatë 36 muajve mund të furnizohet me ato, mund të furnizohet edhe më pak se ato, edhe më shumë se ato. Një marrëveshje shkruhet me 3 eventualisht deri në 6 operatorë të kualifikuar dhe në momentin kur ne kemi nevojë të mos kemi procedura për të pritur 20 – 30 ditë. Na nevojiten kompjuterë u dërgohen të katërve cili na sjell ofertën më të mirë nga këto kriteret, çmimi më i ulët dhe kriteret tjera përkatëse”, ka sqaruar Foniqi.

Tush Dedaj, tha se prej vitit 2005 Dresniku a ka qenë në planifikimet komunale të prokurimit, vetëm kjo po më intereson.

Gjokë Lleshaj, tha mund të jetë edhe gabim teknik, edhe konsideroj se është gabim teknik, por është fjala për shenjëzimin e rrugëve ose vendosja e shenjave të rrugëve. “Mirëpo, me shumën e mjeteve shoh një vend, furnizim - vendosje e shenjave të trafikut vertikal, shuma 10 mijë euro dhe sinjalizimi i rrugëve 5 mijë euro, që kjo shumë nuk mund të jetë, është një shumë tjetër, por kisha kërkuar sqarim se a është gabim teknik apo pëe çfarë bëhet fjalë”, ka shtuar anëtari Lleshi.

Abaz Foniqi, tha se politikat zhvillimore të një regjioni nuk janë punë e imja, se pse nuk përfshihet Dresniku, në procedurë të prokurimit nuk është çështje imja. Nëse me vinë kërkesat prej një drejtorie dhe është e projektuar në buxhet unë me siguri do ta përfshij me plan të prokurimit dhe do të kryheshin procedurat. Se a është Dresniku ndonjëherë në planin e prokurimit aspo nuk është, nëse nuk është në këtë plan, tash unë nuk e di a është, nëse nuk është Dresniku nuk është përgjegjësi imja. Nëse ka ardhur prej një drejtorie një projekt unë nuk mund ta heq as ta shtoj, kjo është. Ndërsa për Gjokën, unë besoj se

janë dy buxhete për shenjëzimin dhe emërtimin e rrugëve. Emërtimi i rrugëve besoj dhe ashtu është në DSHP është një projekt është një procedurë për evidencim, emërim, tabelat emërtuese të rrugëve. Ndërsa në DU është projekt tjetër, Shenjëzimi vertikal dhe horizontal i rrugëve, do të thotë shenjat e trafikut, e ato janë 15 000 euro, 5000 edhe 10 000 janë të konceptuara në DU për tabela të trafikut. I vetmi gabim që është bërë vlera është Qupeva, se këto vlera të tjera qysh i kam marrë prej drejtorive i kam shpërndarë. Ky planifikim tani nga viti që jemi është në E-prokurim, çdo qytetar mund ta shoh, ligji ka paraparë, dhe për herë të parë bëhet në E-prokurim të futen këto të dhëna edhe çdo qytetar ka qasje”, ka sqaruar zyrtari Foniqi.

Tush Dedaj, tha se desha vetëm si informatë që prej vitit 2005, a ka qenë i përfshirë Dresniku në Planin e Prokurimit, nuk pata asgjë personalisht rreth jush. “Desha vetëm si informatë, keni mundësi të ma jepni si informatë edhe në seancën e ardhshme”, shtoi prof. Dedaj.

Abaz Foniqi, tha se unë e di.

Fadil Gashi, tha se Abazi nuk e din mos e mundoni. “Ta keni parasysh: ky është plan i prokurimit, nuk është miratim i buxhetit që parashihen edhe projektet, se kah orientohen edhe projektet. Këtë dallim bëjeni, ne nuk jemi duke miratuar projektet, është plan qysh e kanë sqaruar drejtoritë përkatëse me njësitë buxhetore ashtu ka proceduar Abazi. Ky është plan që është miratuar qysh prej vitit të kaluar, kjo pjesë është miratuar karshi buxhetit që është miratuar vitin e kaluar. Ky nuk ka asnjë gjë tjetër diçka më tepër. Abazi nuk mund t’ju jep asnjë përgjigje rreth kësaj”, tha Kryesuesi.

Kryesuesi vuti në miratim Planin e Prokurimit për vitin 2018.

Me vota unanime (26), pa kundër as abstenim u miratua Plani i Prokurimit për vitin 2018.

Pika e shtatë: Rishqyrtimi i Vendimit për themelimin e KPF-së, sipas kërkesës së MPL.

Fadil Gashi, tha se e kam konfirmimin këtu, e kam shkresën e ministrisë që na ka dërguar. Nuk po e lexoj krejt tekstin por pasusin e fundit: ”MAPL pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të Komunës si më sipër (do të thotë thirret në vendimin e Kuvendit kur e kemi themeluar KPF-në), vlerëson se akti i Komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi”. Na kërkohet brenda 30 ditëve rishqyrtimi i këtij vendimi, ne jemi në afat nëse veç tash e kemi në rend të ditës për të rishqyrtuar, për ta sanuar, për ta përmirësuar, si të doni mund ta quajmë, por sinqerisht po e them nuk e kanë mirë, sepse thotë” Keni rënë ndesh me dispozitat ligjore, infrastrukturën ligjore”, e atë infrastrukturë ligjore nuk e ka askund. Ose është dashur për të na kushtëzuar neve qysh në start kur kemi hyrë në zgjedhje për pushtet lokal me na thënë pjesëmarrja e kandidatëve në listën e përgjithshme duhet për të qenë 50 me 50, edhe atë përbërje të kuvendit e kishim 50 me 50, edhe gjitha trupat tjera kishim për të shkuar 50 me 50, e jo në një organ 50 me 50, ndërsa në një organ tjetër as 30 nuk mund ta plotësojë. Kjo është diçka që ju ka ndodhur vetëm kuvendeve komunale. Këtë nuk ju kërkon institucioneve qendrore dhe as nuk i pyesin ata fare. Mos ma merrni se jam kundër gjinisë, as njëres, as tjetres. Megjithatë, unë po kërkoj vullnet, mirëkuptim prej grupeve tjera, si dhe ne e kemi biseduar me shefat e grupeve, ta gjejmë mirëkuptimin me ata që duhet të hiqen, me ata dy meshkuj që duhet të hiqen. Ne e plotësojmë kriterin 50 me 50 duke iu referuar që kryesuesi shkon sipas funksionit, 6 anëtarë tjerë, 3 meshkuj edhe 3 femra konsideroj se ne e plotësojmë si kriter, edhe ju përcjellim përmirësimin e vendimit edhe ministrisë, edhe agjencionit për barazi gjinore. Unë po kërkoj edhe një herë me shumë dashamirësi prej atyre që janë zgjedhur me

vendim të këtij kuvendi në seancën e kaluar, sepse zgjidh e hiq nuk është në rregull, meqenëse kam në seancën e kaluar, paraprakisht kemi qenë të njoftuar me një qarkore që na kanë dërguara ata. Ne kemi ardhur në këtë pikë. Jemi të obliguar për ta përmirësuar këtë përndryshe pasojat janë tjera që mund të na shkojnë më gjatë dhe më keq”, shtoi kryesuesi, i cili në vijim hapi debatin.

Petrit Palushi, theksoi se si shef i grupit në bashkëpunim me anëtarët tjerë të AAK-së, jemi dakorduar që në vend të Valmir Bacajt të kalojë Blerta Gashi, kurse në vend të Blerta Gashit të kalojë Valmiri, domethënë ta bëjmë një rotacion. Te KPF kalon Blerta, ndërsa te Komiteti për Komunitete kalon Valmir Bacaj. Kështu që KPF propozohet Blerta Gashi, kurse në KK propozohet Valmir Gashi.

Saranda Elezaj, tha se ne si GP deshëm për t’u dhënë mundësinë PDK-së, nëse kanë ndonjë propozim, që jo atëherë vazhdojmë me propozimin tonë. “Atëherë, nëse PDK-ja nuk kanë dikë për të propozuar po bashkëpropozohem, domethënë po e propozoj vetën në këtë komitet, hiqet anëtari Avni Gashi dhe e marr unë në rotacion të parë”, tha ajo.

Xhevxhet Berisha, tha se pasi që e kemi me rotacion për dy vite është dashur që PDK-ja ta ketë kandidatin për KPF.

Enver Berisha, tha se e para, në emër të grupit, kërkojmë që ndoshta jo sot, mirë do të kishte qenë sot, ta kemi një interpretim ligjor rreth përfaqësimit të partive politike në KPF. “Ne besojmë se ne jemi këtu të anashkaluar me një pozitë, me një kandidat, por megjithatë atë ditë ishit insistues, mirë do të kishte qenë për të pasur një interpretim. E dyta, për hir të situatës, ne po marrim si obligim për ta bërë edhe ne një rokadë, në emër të Zeqir Morinës që është në KPF të kalojë zonja Mendehie Duraku, dhe Zeqir Morina të kalojë në Komitetin për Komunitete”, pohoi anëtari Berisha.

Fadil Gashi, sqaroi se LVL se nuk ka tjetër interpretim, LVL veç këtë pasus e ka përjashtuar edhe përgjegjësitë e komiteteve e që po i përmend. “Thuhet: KPF kryesohet nga Kryesuesi i KK dhe përbërja e tij duhet të reflektojë përfaqësimin e etnive politike të Kuvendit të Komunës, asgjë më shumë”, shtoi kryesuesi.

Enver Berisha, tha se megjithatë Komuna ka një Zyrë ligjore, dhe të jetë edhe për arsyetimin tuaj dhe tonin, është mirë që Zyra ligjore le ta jep shpjegimin e vet.

Fadil Gashi, tha se doni për seancën e radhës e ngarkojmë ZL, mirëpo nuk di sa ka mandat për t’i interpretuar ligjet Zyra ligjore, sepse interpretimin ia bën ai që nxjerr, jo ky që ka për obligim për ta implementuar. “Kemi edhe pak telashe se a guxojmë, megjithatë sido që të jetë le të vijnë të na sqarojnë”, shtoi Kryesuesi

Kryesuesi vuri në miratim vendimin e ri me plotësime.

Me vota unanime (26) u miratua vendimi i ri për themelimin e KPF-së.

Fadil Gashi, domethënë KPF plotësohet me dy anëtarë të tjerë, Blerta Gashin dhe Mendehie Duraku, në vend të Valmir Bacaj dhe Zeqir Morinës. “Kështu që, duhet një vendim tjetër se kemi lëshuar vendimin edhe për komunitete”, tha Kryesuesi.

Vuri në miratim vendimin e ri për Komitetin për Komunitete.

Me vota unanime (26) u miratua Vendimi.

Pika e tetë: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Financiar për vitin 2017.

Kryesuesi për prezantim fjalën e barti te drejtori i DFEZH, z. Aziz Desku.

Aziz Desku, drejtor i DFEZH raportoi rreth Raportit të DFEZH për vitin 2017: “Buxheti i planifikuar komunës së Klinës për vitin 2017 në vlerë prej 9.270.769,21 euro është 4.16% më i lartë krahasuar me vitin 2016. Krahasimet në këtë raport financiar do të bëhen duke krahasuar buxhetin sipas parimit: Buxheti i planifikuar-Buxheti i realizuar-Buxheti i shpenzuar. Shumë nga krahasimet në tabelat e këtij raporti janë vetë sqaruese me gjithë atë do të analizojmë disa aspekte të përgjithshme dhe për ndonjë specifikë do të mund të japim sqarime shtesë por sidoqoftë vëmendja me tepër do të fokusohet të të hyrat vetanake dhe të shpenzimet buxhetore.

Disa thekse kryesore nga analiza e Raportit financiar për vitin 2017 kishin me qenë si në vijim:

1. Buxheti i planifikuar nuk është realizuar si rezultat i mosrealizimit të të hyrave vetanake (221.156,00 euro).

2. Si rezultat i mosrealizimit të të hyrave vetanake kemi reduktim të kapacitetit financiar të komunës së Klinës për investime në projekte kapitale të cilat kanë qenë të planifikuara për aq sa nuk janë realizuar ato, pra për 221.156, euro. Kapaciteti financiar i komunës së Klinës për vitin 2018 do të jetë më i vogël për aq sa nuk janë realizuar të hyrat vetanake nga viti 2017 sepse obligimet do të duhet të mbulohen me buxhetin e vitit 2018.

3. Të hyrat vetanake të realizuara në vitin 2017 janë për 31.747,40 euro ose 3.77 % më pak se në vitin 2016.

4. Të disa lloje të shpenzimeve për mallra dhe shërbime kemi keq klasifikime nëpër kode ekonomike por edhe rritje të pajustificueshme (karburantet për vetura janë për 16.161,74 euro më shumë krahasuar me vitin 2016).

5. Nga mjetet e grantit qeveritar buxheti nuk është realizuar për 88.087,00 euro, ndërkohë që përafërsisht aq janë obligimet e pakryera të komunës për mallra dhe shërbime në fund të vitit 2017.

Drejtimet e aktivitetit për përmirësimin e menaxhimit financiar gjatë vitit 2018.

1. Përmirësimi i shkallës së inkasimit të të hyrave vetanake;

2. Rritja e kapacitetit financiar të komunës për investime në projekte kapitale si rezultat i rritjes së inkasimit të të hyrave vetanake.

3. Aktivitete të vazhdueshme në drejtim të zvogëlimit të shpenzimeve për mallra e shërbime;

4. Rritje e cilësisë së realizimit të investimeve të komunës në projekte kapitale sipas parimit : Vlera me e mirë për vlerën e njëjtë të parasë së shpenzuar.

5. Rritja e aktiviteteve të Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, ekzekutivit të Komunës së Klinës dhe pse jo edhe i Kuvendit komunal në drejtim të inkasimit të të hyrave vetanake dhe zvogëlimit të obligimeve të taksapaguesve të komunës së Klinës”, ka prezantuar drejtori Desku.

Petrit Palushi, tha se ndoshta pa të drejtë me duhet për t’ia bërë një pyetje drejtorit, z. Desku, edhe pse vitin e kaluar nuk ka qenë drejtor, desha të informohem për pagesat për sindikatë, 25 mijë euro, shpenzime do të thotë, për cilën sindikatë bëhet fjalë, edhe anëtarësi të koda e infermierëve të Kosovës Domethënë pse është bërë kjo pagesë unë e di, jam vetë anëtar i odës dhe pagesat i bëjmë vetë, prandaj nuk po e kuptoj këtë shpenzim”, shtoi anëtari Palushi.

Valmir Bacaj, tha se unë kam dy pyetje, tek kategoria paga dhe mëditje, numër 17, shërbime kontraktuese e tjera, që është 126 66.77 cent, që është dallimi nga viti i kaluar 24 635 në krahasim me vitin e kaluar, për çfarë shërbime bëhet fjalë dhe shërbime për anëtarësime, që është 8 mijë euro, ndërsa në vitin 2006 nuk ka pasur. “Çështje tjetër është karburanti për vetura ka rritje drastike në krahasim me vitin 2016, 16 161 euro, që është më shumë, në cilët muaj ka ndodhur kjo rritje se kjo ka rëndësi të madhe. Edhe si koment në fund, raporti paska negative dhe pozitive, pozitive qenka se në vitin 2017 nuk paskemi pasur pagesa për vendimet gjyqësore, qysh ka qenë në vitin 2016 se kanë qenë 91. 298.76, që vlen për të përshëndetur”, ka pohuar anëtari Bacaj.

Tunë Dedaj, tha se unë personalisht kam vërejtje të mëdha te këto shpenzimet e mëdha, si te derivatet e naftës që i kanë bërë, siç i potencoi edhe drejtori, por kisha pasur një kërkesë prej Drejtorit të Shëndetësisë se deri tashti kemi kritikuar ne PDK-në që kanë qenë në pozitë, tash jemi ne. “Unë kam qenë në SHSH dhe kam vërejtur që aty është një keqpërdorim i nxehtë, edhe nxehtë qendrore e lëshuar, edhe nxehtë elektronike, nxehtëset, edhe dera e hapur! Tri-katër herë kam përcjellë dhe kam vërejtur këtë keqpërdorim. Nëse ka nevojë 24 orë le të jetë nxehtë qendrore, mirëpo në mënyrë urgjente t’iu hiqen ato nxehtë elektronike”, ka shtuar anëtari Dedaj.

Aziz Desku, tha se në pyetjen që ka të bëjë për pagesat për sindikatë, domethënë këto pagesa janë për sindikatat për të cilat punëtorët vetë deklarohen për pagesën e këtyre mjeteve, edhe në këtë mënyrë atyre në paga iu ndalen ajo përqindja dhe shkon në fondin e sindikatës, qoftë të administratës komunale apo të arsimit. Sa i përket pagesës së anëtarësisë në Odën e infermierëve si shpenzim analitik, sipas kësaj nëse ka ndodhur nuk është dashur të ndodh, domethënë janë shkelur rregullat dhe procedurat për arsye se këto anëtarësime paguhen nga vetë individët në ato oda ose forma të organizimit sipas profesioneve të caktuara. Te shërbimet kontraktuese që ka një rritje bukur të madhe, ndoshta përgjigjen e plotë nuk kisha pasur mundësi për ta dhënë sot, megjithëse përgjigje të pjesërisht mund ta jap, edhe kjo ka të bëjë me angazhimin e punëtorëve, domethënë në mënyrë kontraktuese, kjo puna me kontratë në vepër, megjithëse për shpenzimet detale për këtë kategori përgjigjen mund ta jap në seancën e radhës, për secilën drejtori ka sa janë këto shpenzime dhe ku janë më të mëdha dhe për çka janë shpenzuar. Sa i përket shërbimeve për anëtarësim, këtu ka të bëjë për pagesat që bëhen, siç është pagesa për AKK ose me ndonjë organizim të këtij lloji, edhe këtë po dua të them, për vlerat konkrete që janë në këtë raport vlerën e saktë mund ta jap nis seancën e ardhshme. Te shpenzimet e derivateve, veç ishte konstatimi që ato janë të rritura edhe të pajustificueshme, edhe nëse e krahasojmë me periudhën e kaluar, por edhe vetë si të tilla vetvetiu për buxhetin e vitit 2017”, ka konstatuar drejtori Desku.

Enver Berisha, tha se e para po dua ta falënderoj drejtorin për një analizë bukur detale që i bëri raportit të ekzekutivit të vitit të kaluar. “Ndoshta më me shumë detale sa që është dashur ta bëjë. Por e kuptoj drejtorin se një përqindje bukur e madhe i takon edhe aspektit politik që ju u munduat për ta shfaqur këtu përmes këtij raporti. Por, sido që të jetë këto janë shifra që nuk ndërrohen për hir të askujt, janë fonde, janë buxhete në evidencë që janë ashtu siç janë, po megjithatë unë them se këtu ka parametra shumë pozitive në kuadër të këtij buxheti, sado që drejtori bën përpjekje për t’i minimizuar ato pozitivet, por mendohej për t’u ndalë te pjesa e obligimeve që kanë mbetur dhe te ndonjë nuancë e ndonjë përzierje të kodeve të këtij buxheti. Por, qoftë se merret granti qeveritar, nëse merren donacionet që janë investuar, por, duke e ditur se edhe parametrat e të hyrave vetanake, drejtori i njuh shumë mirë, i njuh edhe një pjesë e stafit këtu që është, duke përfshirë edhe kryesuesin, jo shumë herë varen nga qasja dhe nga angazhimi i vetë ekzekutivit. Janë taksa dhe tatime që diktojnë edhe qytetarët përmes

angazhimeve, përmes punëve të tyre, përmes investimeve edhe të funksionimit të bizneseve të caktuara. Kështu që, mund të ndodh që edhe në kuadër të planifikimeve të ketë edhe mospërputhje me alokimin. Por, unë mendoj që nga 2015 nëse merren dhe këqyren parametrat buxhetorë Komuna e Klinës ka pasur raporte pozitive në të gjitha segmentet, qoftë në donacione, qoftë në grante qeveritare, qoftë edhe në të hyrat vetanake. Le ta bëjë drejtori krahasimin e vitit 2014 me 2015, e sheh se sa ndryshim drastik ka pozitiv pasur në të hyrat vetanake. Kështu që, është mirë realisht për ta vlerësuar atë punë që është bërë, për ta vlerësuar atë fond që është siguruar ngado që ka ardhur, dhe unë jam i vetëdijshëm se ju dhe ne bashkërisht duhet bërë përpjekje që tjetrën herë për ta rritur angazhimin tonë dhe për ta forcuar buxhetin prej mundësive që na i krijon edhe qytetaria, por edhe Komuna, por edhe duke përfshirë edhe grantet dhe donacionet. Mirëpo, sido që të jetë unë bashkë me GP sot e kemi vendosur që të gjitha këto pika të rendit të ditës që janë për t'i aprovuar, për faktin se deri këtu kemi qenë pjesë e angazhimeve bashkërisht dhe nga këtu fillon pjesa e angazhimeve tuaja dhe pastaj të shohim si do të ecin këto ecuri të zhvillimeve, por realisht ata që mendojnë për të menduar logjikshëm, arsyeshëm dhe me mendje të qartë dhe të shëndoshë është që ky buxhet dhe ky shpenzim që është bërë është jashtëzakonisht pozitiv dhe është mirë për t'u vlerësuar”, ka konstatuar anëtari Berisha.

Saranda Elezaj, tha se e kam një pyetje për drejtorin, te pika 28, furnizime me ushqime pije, jo dreka, edhe dreka zyrtare, desha sqarim, se ushqimi a është i paguar edhe për punëtorët e Komunës apo për çfarë bëhet fjalë, desha një sqarim rreth çështjes, furnizim dhe pije dhe pika 49, dreka zyrtare.

Xhevxhet Berisha, tha se kisha falënderuar drejtorin e Financave për këtë raport që ka përgatitur për aq sa ka pasur qasje, por unë kisha kërkuar edhe prej Kryetarit dhe gjithë partnerët që ka në koalicion, që të mos humbim kohë me ato që kanë përfunduar, por të fillojmë menjëherë për një angazhim, që të gjitha ato që janë të planifikuara nga ZP, që të fillohet me hapjen e tenderëve sa më herët dhe të intervenohet aty ku ka mundësi më shpejt. “Ato të dhëna në qoftë se janë negative le të mbeten pasqyrë krahasuese për për 4 vitet e qeverisjes së sotme. Kështu kryetar, ju bashkë me partnerët e koalicionit dhe të mos mbeten tenderët e hapur në vjeshtë por të fillohet qysh tash dhe të intervenohet sa më shpejt. Unë për shembull kisha kërkuar te instalimi i dy pompave të BL Sferkë, ju kisha lutur me emergjencë që të vendosen. Është rruga që lidhë Krusheven me ato fshatrat të Pejës, aty kush kalon do të shkojë duke notuar! Kështu që është e paarsyeshme të merrem me krahasime, qoftë negative, qoftë pozitive, por më mirë është që ne të ecim sa më përpara dhe të gjitha ato mangësi që janë të përmirësohen”, ka theksuar anëtari Berisha.

Aziz Desku, tha se desha me dhënë një përgjigje për pyetjen që dha Saranda, te kategoria për ushqim, kjo më tepër ka të bëjë për koktejet e rastit në raste të manifestimeve të caktuara dhe duhet të ketë parasysh se nuk ka të bëjë vetëm me administratën komunale, por ka të bëjë edhe me arsimin dhe shëndetësinë, respektivisht me komplet buxhetin e Komunës. Ndërsa, drekat zyrtare thjesht janë ato shpenzime që krijohen me rastin e shpenzimeve të reprezentacionit edhe me mysafirët dhe me pjesën që drejtorët e drejtorive sipas vendimit, d.m.th. në atë 50 euro për muaj, që është një vendim i mëparshëm edhe i kahershëm. Jo në vend të replikës, por të përgjigjes, e tha edhe vetë Enveri që shifrat janë vetë faktet, d.m.th. të hyrat vetanake që kanë qenë të planifikuara 1 28 000, dhe janë realizuar veç 8 9000 ose që thashë që për 221 mijë euro janë më pak, d.m.th. ky është një fakt që nuk mund t'i ikim. Por ndoshta ai arsyetimi domethënë që ne s'kemi mundur për t'i siguruar dhunshëm prej taksapaguesve dhe nëse pak a shumë qëndron, është fakti tjetër që 88 mijë për shkak të menaxhimit të dobët kanë mbetur pa u paguar obligimet, d.m.th. ato kanë shkuar suficit në BKK, kur dihet që me raportin e shpenzimeve, domethënë që drejtoria jonë është e obliguar për të raportuar në Thesar janë diku mbi 100 mijë euro

shpenzime për mallra dhe shërbime të papaguara, që do të thotë do të jenë barrë e buxhetit për vitin 2018. Ndërsa te projektet kapitale po ashtu për shkak të menaxhimit jo të mirë ose të procedurave të prokurimit të udhëhequra me vonesë në realizimin e projekteve edhe të ndryshme kapitale, domethënë Komuna e Klinës ka obligime për katër projekte kapitale diku në vlerë prej 6 40 mijë euro, që janë domethënë projekte që janë realizuar në bashkëpunim me memorandumet e mirëkuptimit me Ministrinë e Infrastrukturës e për të cilat me angazhimin tonë, të kryetarit personalisht, edhe të DU, kemi arritur që qysh tash, një vlerë prej 3 40 mijë euro, domethënë i kthehet Komunës të Klinës, e cila për shkak të vonesës në realizimin e projekteve Ministria e Infrastrukturës i ka orientuar këto mjete në komuna ose në projekte tjera që kanë pasur progres më mirë të realizimit të këtyre projekteve. Do të thotë se pak a shumë unë paraqita vetëm më shumë në aspektin profesional në këtë analizë të raportit dhe jo thjeshtë ndonjë paraqitje politike. Faktet janë fakte dhe ato nuk mund të ndryshohen nga askush, ashtu qysh e tha edhe vetë Enveri”, ka konstatuar drejtori Desku.

Enver Berisha, tha se ish drejtori z. Gashi është këtu e di më mirë këtë çështje, por unë për shkak të korrektësisë desha për të ngritur një gjë që ju po e thoni. “E para, është mirë për ta këqyrë kur ka ndodhur ai memorandum bashkëpunimi në mes të Komunës dhe Ministrisë. Deh prej nënshkrimit të atij memorandumit të bashkëpunimit, sa është afati kohor që është shpallur tenderi i caktuar dhe deri ku ka mbërri puna. Nuk besoj se është çështje e vonesave të procedurave dhe të angazhimeve të kompanive, e them për faktin se Ministria ka menaxherin e vet që i këqyr këto projekte, të paktën këto të infrastrukturës rrugore. Dhe asnjë veprim dhe asnjë punë nuk bën të mbetet pa pëlqimin edhe pa mendimin edhe të atij menaxheri që është i caktuar në kuadër të Ministrisë. Këto obligime, që në një mënyrë ministria i ka dedikuar ato mjete për Komunë dhe prapë i ka tërhequr, nuk është Komuna fajtoare ose përgjegjëse pse ka ndodhur kështu. Sepse me vetë faktin se ndoshta memorandumet janë shkruar me vonesë dhe zhvillimi i procedurave ka pasur kohën e vet, është çështje që nuk është varur thjeshtë prej një kryetari ose thjeshtë prej një nevoje të caktuar”, ka shtuar anëtarë Berisha.

Kryesuesi vuri në miratim Raportin financiar të DFEZH për vitin 2017.

Me 25 vota për, pa kundër dhe pa abstenim u miratua Raporti.

Pika e nëntë: Propozim-vendimi për themelimin e pesë komiteteve tjera të Kuvendit.

Fadil Gashi, prezantoi komitetet të cilat duhet të formohen:

- **Komiteti për Shëndetësi Sociale**
- **Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini e Sport**
- **Komiteti për Planifikim Urban, Ekonomi dhe Zhvillim**
- **Komiteti për Shërbime Publike dhe**
- **Komiteti për Pronë**

Këto janë pesë komitetet tjerë, besoj që me themelimin e tyre e kompletojmë komplet trupat e Kuvendit. Ju e dini çelësi është 5 anëtarë janë të sanksionuar me rregulloren për punën e komiteteve dhe përbërjen e tyre, edhe me Rregulloren e Punës së Kuvendit. Kisha propozuar pasi që numrin e kanë më të madh PDK-ja, fillimisht fillojmë me 2 anëtarë të PDK-së, 1 LDK, 1 AAK edhe 1 grupi VV-NISMA dhe AKR”, tha kryesuesi dhe hapi debatin. Nuk kemi mundësi për të plotësuar krejt me anëtarë të Kuvendit, sepse nuk kemi, mund të propozoni edhe jashtë Kuvendit anëtarë në këto komitete. Besoj që jeni të përgatitur sepse paraprakisht kemi biseduar edhe me shefat e grupeve, kemi kërkuar të jem të përgatitur, meqenëse

edhe në seancën njëfarë thirrje e kam bërë që të përgatiteni për propozime në këtë seancë”, theksoi kryesuesi i cili hapi debatin.

Valmir Bacaj, tha se vetëm kisha kërkuar prej kolegëve, që propozimet kur të shkojnë për të respektuar edhe pikën 3 të këtij vendimi, duke respektuar përvojën përkatëse dhe kriteret profesionale, të paktën të dimë për kë po votojmë, kualifikimin edhe përvojën e atij kandidati. “Të mos votojmë njerëz sa për mëditje por ata të cilët kanë mundësi të japin kontributin e tyre në angazhimet e kërkuara”, shtoi ai.

Fadil Gashi, tha se edhe kërkesa për themelim këtë e ka kriter. “Këto janë trupa profesionale dhe që i shërbejnë Kuvendit, do të thotë janë në Shërbim të Kuvendit, edhe punojnë për Kuvend, edhe është mirë për t’iu qasur profesionalizmit të kushteve, edhe keni, nuk besoj që nuk keni kuadro të profileve gjegjëse”, tha Kryesuesi.

Enver Berisha, tha se duke u bazuar në takimin që patëm me shefat e grupeve kuvendare nuk kisha debatuar më këtu, mirëpo kisha hyrë në propozime konkrete. “Besoj se edhe grupet tjera kuvendare do të pajtohen me atë qëndrim që është ardhur. Besoj që ne e kemi lehtësuar sado pak bashkërisht atë ditë. Dhe duke e pasur parasysh që ne si grup më i madh parlamentar u dakroduam që t’i kemi nga 2 anëtarë, gjithmonë duke u thirrur në qëndrimin çfarë e shfaqti zoti Bacaj që me anëtarë nga jashtë që kemi planifikuar t’i kemi tamam profesionalë të asaj fushe që këtu po kërkohet me vendosur në kuadër të këtyre komiteteve”, theksoi anëtari Berisha.

U procedua me propozimet e anëtarëve të komiteteve

Në Komitetin për Shëndetësi:

Enver Berisha, propozoi Elvira Bacaj dhe Dr. Ali Ahmetxhekajn
Enver Berisha (LDK), propozon Dr. Augustin Selmanajn
Petrit Palush AAK, propozon Dr. Petrit Palushin
Xhevxhet Bashota (vv), propozoi Zafer Gashin

Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport:

Enver Berisha (PDK), propozoi Besart Hotin dhe Halil Deskun
Violeta Zefi (LDK), propozoi Sefë Morinë
Petrit Palushi (AAK), propozoi Skënder Maxharajn
Saranda Elezaj (VV), propozoi Urim Gashin

Komiteti për Planifikim Urban, Ekonomi dhe Zhvillim:

Enver Berisha (PDK), propozoi Baki Gashin dhe Asdren Ramadanin
Augustin Selmanaj (LDK), propozoi Saranda Zeqën
Petrit Palushi (AAK), propozoi Xhezide Trepça- Gashin
Saranda Elezaj (VV), propozoi Halil Arifin

Enver Berisha, tha se e kam thënë atë ditë po e them edhe në prezencën e gjithë asamblistëve: Nëse mbetet ndokush prej anëtarëve të AK i papërfshirë, të grupeve tuaja parlamentare që jeni në pushtet, unë mund për t’u tërhequr, mirëpo nuk mund të tërhiqem në bazë të fuqisë politike dhe të njerëzve që ju doni për t’i propozuar nga jashtë, të jemi korrekt në këtë rast.

Saranda Elezaj, propozoi Mimoza Mehaj

Petrit Palushi, tha se në mbledhjen e shefave jemi dakorduar që PDK-ja me qenë ata anëtarë që janë asamblistë për t'u përfaqësuar nga 2, mirëpo grupet tjera vetëm nga 1, sepse atëherë pi bie fuqia politike.

Fadil Gashi, tha se edhe atëherë edhe sot insistimi edhe i Enverit, edhe i imi, në këtë rast mund të përfshihen edhe këta 2 që nuk kanë grup. "Ju dy palët ju lejoni nga një vend, janë 2 komitete le të hynë. Po e deshifrojë krejt atë që nuk desha për ta deshifruar. Mos të na mbesin dy anëtarë të Kuvendit pa i përfaqësuar.

Enver Berisha, tha se AAK po insiston që t'i sjell dy anëtarë që nuk janë anëtarë të Kuvendit, kjo nuk është në rregull.

Petrit Palushi, tha se atëherë unë po e propozoi në Komitet për Shërbime, Tush Dedajn. Ne duhet t'i përfaqësojmë të gjithë anëtarët e KK, kur t'i kryejmë gjithë anëtarët e Kuvendit pastaj mund të propozojmë edhe nga jashtë Kuvendit.

Tunë Dedaj, tha se qëllimi ynë është që të mos mbes ndonjë anëtar i Kuvendit pa u përfaqësuar në komision, edhe ne si grup i AAK, e propozoi Tush Dedajn, edhe mua më vjen mirë po që se Tushi pranon për të qenë i përfaqësuar prej nesh.

Tush Dedaj, tha se unë nuk kam ndonjë arsye për ta pranuar për arsye se kjo po bëhet me dhunë të një rregulloreje, prandaj unë nuk jam në gjendje për ta pranuar këtë, i vetmi vend ku kisha pranuar kishte për të qenë sporti, megjithatë aty nuk u përfaqësova dhe nuk prishet asgjë dhe të vazhdojë në këtë mënyrë.

Fadil Gashi, tha se temën e ke të gabuar, kjo nuk është dhunë, këto janë propozime, krejt normale, jemi në respektim të procedurave dhe rregulloreve, mua më duhet propozimi.

Tunë Dedaj, tha se Tush, me vjen keq që askush nuk ka përdorur dhunë ndaj teje, ne e vlerësuam për të mos mbetur anëtar as nuk kemi biseduar me ty, as nuk kemi kërkuar ndihmë, por kemi pasur dëshirë që si anëtar i Kuvendit të jesh anëtar i një komisioni. "Nëse nuk e pranon nuk është asnjë problem, atëherë shkojmë me nga një propozim edhe PDK-ja çon kë ka dëshirë vetë, çdo gjë është në rregull", pohoi anëtari Dedaj.

Komiteti për Shërbime publike ka këtë përbërje:

Enver Berisha (PDK), propozoi Esat Racin dhe Kolë Prenajn

Violete Zefi (LDK), propozoi Leonora Besim Gashin

Petrit Palushi (AAK), propozoi Nikson Dakën

Saranda Elezaj(VV), propozoi Mimoza Mrijajn

Zenun Elezaj, tha se unë mendoj që PDK-ja le të shkojnë me dy prapë, edhe ne është mirë për të bërë një kompromis edhe Tushin për ta përfshirë, ose ne ose VV-ja, njëri, jo imponim ose dhunë, respektivisht me gjetur një konsensus ose VV-ja ose ne në Komitetin për pronë për ta propozuar Tushin, mirë është të përfaqësohet Tushi.

Gjokë Lleshaj, tha se i falënderoj për propozim, prandaj edhe po e pranoj këtë propozim. “Pavarësisht se po dal jashtë teme: me pasur mundësi në të ardhmen për të na siguruar teknika e zorimit, se edhe juve po ju vonojnë me dalë në foltore . Dhe, pse nuk kemi edhe një grup parlamentar askush nuk na ka faj”, shtoi anëtari Lleshaj.

Zenun Elezaj, tha se kisha propozuar që AAK-ja, jo me imponim, për ta propozuar Tushin dhe VV-ja Avniun dhe të jenë të gjithë anëtarët e Kuvendit të përfshirë.

Tush Dedaj, tha se edhe më herët thamë se duhet të shikohen anët profesionale të njerëzve, të kandidatëve, në mënyrë që të jemi më në nivel, edhe zgjedhja, edhe puna e atyre komiteteve. “Atëherë kur unë kisha vendin për t’u përfaqësuar, nuk u propozova, prandaj unë nuk jam në gjendje për të pranuar për hir të një rregulloreje me dhunë. Nuk jam për t’u përfshirë në ndonjë prej këtyre komiteteve, ku nuk kam ndonjë njohuri të veçantë profesionale ose nuk mund të jap ndonjë kontribut ndoshta edhe pritët”, pohoi ndër të tjera anëtari Dedaj.

Fadil Gashi, tha se ne jemi këtu për të zgjedhur organe, për të zgjedhë trupa, edhe është vullnet i këtyre anëtarëve të Kuvendit të propozojnë.

Komiteti për Pronë:

Enver Berisha (PDK), propozoi Isa Ibishin dhe Gjokë Lleshin (IPK)
Petrit Palushi (AAK), propozoi Pal Canajn
Sefë Morina (LDK), propozoi Agron Ndrecajn
Saranda Elezaj, propozoi Liridon Morinën


Vuri në miratim në tërësi të gjithë komitetet.

Me vota unanime 24, pa kundër e pa abstenim, miratohet vendimi për formimin e pesë komiteteve.

Kryesuesi falënderoi anëtarët për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë.
Seancën e konstatoi të mbyllur.

Seanca përfundoi në orën 12.25 minuta.

Procesmbajtësi,
Mikel GOJANI



Kryesuesi i Kuvendit,
Fadil GASHI

